

VENDIM
Nr.748, datë 9.12.2005

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË MALLRAVE REZERVË SHTETËRORE

(Ndryshuar me VKM nr.192, datë 11.4.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “ë” e 8, shkronja “h” të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” , me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore me fondin prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, të realizojë blerjen e artikujve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për krijimin e fondit të mallrave rezervë shtetërore.

2. Ky fond të përballohet nga llogaria rrjedhëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore.

Fondi limit për prokurimin e artikullit miell të jetë në funksion të sasisë dhe të çmimit mesatar, që do të rezultojë nga testimi, privat dhe zyrtar, i tregut.

3.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të bëjë shpërndarjen e artikujve, sipas përcaktimeve të Ministrisë së Brendshme.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr	Artikujt	Njësia e matjes	Sasia
I	Artikuj për përdorim të menjëhershëm		
1	Miell	ton	600
2	Oriz	ton	80
3	Sheqer	ton	80
4	Makarona	ton	70
5	Vaj ushqimor	ton	50
6	Fasule	ton	50
7	Konserva perime	ton	30
8	Konserva mishi	ton	10
9	Kripë	ton	5
10	Sapun	copë	30 000
11	Detergjent	ton	30